

URDHËR
Nr.63, datë 7.9.2010

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TAKSËS
MBI TRUALLIN SHTETËROR NË PËRDORIM

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 7 pika 2 të ligjit nr.10 270, datë 22.4.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, Ministri i Financave

URDHËRON:

1. Miratimin e formularit të deklarimit dhe pagesës së taksës mbi truallin shtetëror në përdorim”, sipas formatit dhe udhëzimeve bashkëlidhur.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE

FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TAKSËS MBI TRUALLIN SHTETËROR
NË PËRDORIM

Numri i vendosjes së dokumentit (NVD) (Vetëm për përdorim zyrtar)	
1. Periudha tatimore	2.Nr.i deklarimit
a) Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-i)	
b) Emri tregtar i personit të tatueshëm	
c) Emri, mbiemri i individit	
d) Adresa:	
e) Numri i telefonit	
Llogaritja e taksës për truallin në përdorim	
3. Sipërfaqja e truallit shtetëror në përdorim në m ²	x
4. Çmimi i truallit shtetëror në përdorim në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave	x
5. Niveli i taksës	x
6. Taksa vjetore e llogaritur (3x4x5)	x
7. Muaj të truallit shtetëror në përdorim	x
8. Taksa për t'u paguar (6/12x7)	x
Të dhëna shpeshë mbi sipërfaqen e truallit shtetëror në përdorim	
9. Numri i aktit ligjor mbi bazën e së cilës zotërohet trualli shtetëror në përdorim	x
10. Vendndodhja e truallit shtetëror në përdorim	x
11. Genplani i bashkëlidhur	
Shënim. Në çdo deklarim do të plotësohen pikat 1 dhe 2 për të dhënat shpeshë, ndërsa genplani do të dorëzohet vetëm një herë.	

Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

Data ____/____/____/

Firma e personit të tatueshëm

Vetëm për përdorim zyrtar

PAGESA

Lekë
Xhirim
Çek
Të tjera

Shuma e paguar

--

tatueshëm

Kopja-Personi i

Origjinali-Zyra e tatimit

Data, vula e bankës, nënshkrimi i nëpunësit të bankës

SQARIME MBI PLOTËSIMIN E FORMULARIT, TË DEKLARIMIT TË PAGESËS SË TAKSËS MBI TRUALLIN PËR PËRDORIM

1. Periudha tatimore: Poshtë emërimit do të shënohet viti fiskal për të cilin bëhet deklarimi.

2. Numri i deklarates së truallit shtetëror në përdorim për të cilat bëhet deklarimi. Për çdo vendndodhje truall në përdorim do të bëhet një deklaratë e veçantë.

a) Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT) i personit juridik apo fizik. Individët e paregjistruar si persona tregtarë do të vendosin numrin e kartës së identitetit dhe në mungesë të saj numrin e pasaportës.

b) Emri tregtar i personit të tatueshëm; sipas regjistrimit në organin tatimor.

c) Emri, mbiemri i individit që zotëron truall në përdorim dhe paguan taksën.

d) Adresa sipas rastit e personit juridik, fizik apo individit, që zotëron truall shtetëror në përdorim dhe paguan taksën.

e) Numri i telefonit sipas rastit i personit juridik, fizik apo individit që zotëron truall shtetëror në përdorim dhe paguan taksën.

3. Sipërfaqja e truallit shtetëror në përdorim në m² që zotërohet sipas aktit ligjor.

4. Çmimi i truallit shtetëror në përdorim në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.10 270, datë 22.4.2010.

5. Niveli i taksës i miratuar me ligj.

6. Taksa vjetore e llogaritur, që del nga shumëzimi i rubrikave (3x4x5).

7. Muajt e truallit në përdorim tregojnë numrin e muajve për periudhën fiskale përkatëse, për të cilat subjekti gëzon të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror.

8. Taksa për t'u paguar: del nga pjesëtimi i rubrikës 6 me 12 (muaj) dhe rezultati që del nga pjesëtimi shumëzohet me rubrikën 7.

9. Numri i aktit ligjor mbi bazën e të cilit zotërohet truall shtetëror në përdorim.

10. Vendndodhja e truallit në përdorim tregon vendndodhjen e truallit shtetëror në përdorim për të cilën bëhet deklarimi.